



A.nr.02/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.02/2026, të datës 05.01.2026, të parashtruar nga ankuesi D.J nga Ranillugu, kundër organit të punësimit: Komuna e Ranillugut, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.02/2026, e datës 05.01.2026, e parashtruar nga ankuesi D.J.

A r s y e t i m

Ankuesi D.J (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 26.12.2025, përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 05.01.2026 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.02/2026 për shkak të mos zbatimit të aktit të emërimit për pozitën Zyrtar për Kulturë në Komunën e Ranillugut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ranillugut, ndërsa, përkundër disa kërkesave, kjo e fundit, më datë 29.05.2026, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) **administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 08/2026 të datës 05.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 10.10.2025 të ankuesit; Njoftimin e datës 11.11.2025 të ankuesit për Menaxheren e Burimeve Njerëzore; Njoftimin

e datës 07.11.2025 të ankuesit; Raportin mbi përmbledhjen e daljes nga spitali me epikrizë datë 06.11.2025; Akt Emërimit e datës 10.10.2025; Zarfën e datës 26.12.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 29.05.2026; Njoftimin e datës 13.01.2026 nga Arkiva për ankuesin; Emailin e datës 11.11.2026 nga M.C për ankuesin; Emailin e datës 03.11.2026 nga A.K për M.C; Emailin e datës 31.10.2025 nga M.C për S.Gj; Vendimin e datës 05.12.2025 për përfundim të mandatit të asamblistit të ankuesit; Njoftimin e datës 23.12.2025; Deklarata e datës 23.12.2025 nga Menaxherja e Personelit; Listën e nënshkrimeve datës 31.10.2025; Listën e komisionet për financa Komuna e Ranillugut datë 30.10.2025; Listën e pagave për ankuesin tetor 2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Komuna e Ranillugut, më datë 08.07.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00018168, pozita Zyrtar për Kulturë, klasa profesional 2, me afat aplikimi 09.07.2025 deri 07.08.2025.

- Në këtë konkurs kishte aplikuar ankuesi dhe së sipas aktit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 08.09.2025, rezulton se ankuesi ka qenë i vetmi kandidat i suksesshëm, dhe mbi këtë bazë është shpallur kandidat fitues me 72.6 pikë, ndërsa, më datë 10.10.2025, të njëjtit i është ofruar nënshkrimi i aktit të emërimit, mirëpo, po më në të njëjtën datë pra më 10.10.2025, kishte paraqitur një kërkesë me bazën citojmë: *që për shkak të pamundësisë që të lë procesin e kandidatit në zgjedhje lokale deri në përfundim (deri sa të dalin rezultatet përfundimtare) dhe deri sa të publikohet lista zyrtare, si dhe për shkak të gjendjes shëndetësore që kam, kërkoj nga komuna që të miratojë këtë kërkesë sipas ligjit për shërbimet civile dhe sipas Rregullores (QRK) Nr. 15/2023, neni 15 paragrafi 3 dhe të më jepet leje për një muaj një muaj nga data 15.10.2025 deri më 06.11.2025 për rehabilitimin e këmbës, pasi që këmben e dhathtë e kam të thyer dhe për shkak të lëvizshmërisë së kufizuar, duhet të shkoj për trajtim spitalor dhe pas kthimit do të dorëzoj listën e daljes si dëshmi e trajtimit.*

-Tutje, më datë 23.11.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ranillugut pas shkresës së DMZP-së të datës 03.11.2025 ka publikuar në SIMBNJ parashtresën më nr. Prot: 01-1012/2025, për shpallje të pavlefshëm të aktit të emërimit të datës 10.10.2025 dhe të konkursit respektiv, ndërsa më datë 13.01.2026, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ranillugut, ka përcjell për ankuesin akt njoftimin më nr.protokolli 01-011/2026, duke e njoftuar se ex officio e ka shpall të pavlefshëm aktin e emërimit të ankuesit të datës 10.10.2025, më arsyetimin së i njëjti nuk ka ofruar prova për dorëheqje si deputet komunal dhe së akt dorëheqja e datës 05.12.2025, nuk mund të ketë efekt retroaktiv.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se komuna ka qenë në dijeni që jam më mandat të delegatit dhe ky mandat ka përfunduar me zgjedhjet e 12 nëntorit 2025. Komuna ka bërë shkelje pasi që unë edhe pse e kam nënshkruar akt

emërimin kam kërkuar që të paraqitem në punë për shkak të problemeve shëndetësore, e për rrjedhojë pas shërimit kam njoftuar se kthehem në vendin e punës. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimin për anulimin e konkursit dhe të obligohet institucioni që të zbatoj rezultatin e konkursit.

Vlerësimi i Kolegjit

Duke qenë se ankuesi ishte shpallur kandidat fitues për pozitën respektive, Kolegji ju referua bazës në fuqi lidhur me emërim në shërbim civil gjegjësisht nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, (akt ky i aplikueshme në atë kohë) më të cilin përcaktohet se: *1. NjMBNj pas kryerjes së verifikimit, emëron kandidatin sipas përcaktimeve në LZP. 2. Pas marrjes së Aktit të Emërimit, kandidati fitues duhet të paraqitet pranë institucionit ku është emëruar, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë nga data e marrjes së Aktit të Emërimit. 3. Afati sipas paragrafit 2. të këtij neni, mund të zgjatet me kërkesë të kandidatit, për shkaqe të arsyeshme dhe me pajtimin e institucionit deri në një (1) muaj, duke përfshirë afatin fillestar. 4. Në rast të mos paraqitjes sipas paragrafit 2. apo 3. të këtij neni, NjMBNj vijon procedurën për anulimin e Aktit të Emërimit dhe kandidati nuk ka të drejtë të emërohet në një pozitë të shërbimit civil, përveç kur i nënshtrohet procedurës së re të konkurrimit. 5. Në rast se NjMBNj anulon aktin e emërimit sipas paragrafit të 4 të këtij neni, vazhdon procedurën me emërimin e kandidatit të radhës që ka arritur së paku shtatëdhjetë (70) pikë. 6. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil themelohet në bazë të Aktit të Emërimit dhe është marrëdhënie pune nën kushtin e konfirmimit në fund të periudhës së provës.*

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji në mbështetje të provave të kësaj çështje administrative ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ranillugut ankuesit si kandidat fitues brenda afatit ligjor i ka ofruar aktin e emërimit duke kërkuar nga i njëjti që të ofronte aktin e dorëheqjes nga pozita e asamblastit komunal pranë kësaj komune, ndërsa, ankuesi përkundër që nuk kishte marr përgjigje nga organi punëdhënës lidhur me kërkesën për shtyrje të afatit, i njëjti kishte vazhduar të mbajë pozitën e Asamblastit në Kuvendin Komunal të Ranillugut, ashtu që sipas thënieve në ankesë ai ishte paraqit në punë me datë 07.11.2025 dhe ka punuar disa ditë, ndërsa, më datë 05.12.2025, ka ofruar aktin e dorëheqjes nga pozita e asamblastit duke u bazuar në Vendimin me numër protokolli 02-124/2025, për përfundimin e mandati të asamblastit dhe anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa. Andaj, mbi këto rrethana, ankuesi nuk ka respektuar dispozitat e nenit 15 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kolegji, thekson faktin së pozita asamblast konsiderohet si funksionar i zgjedhur sipas nenit 3 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, andaj, një nëpunës civil në të njëjtën kohë nuk mund të ushtroj detyrën e të zgjedhurit/ në këtë rast asamblastit komunal dhe pozitën e nëpunësit civil, pasi që, duke u bazuar në nenin 69, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, emërimi si asamblast komunal përben shkak ex lege që pozita në shërbim civil duhet të pezullohet sipas detyrës zyrtare. Në ndërlidhje me këtë konstatim, Kolegji vlerëson së pezullimi i pozitës mbi këtë bazë ligjore, vie në shprehje vetëm nën kushtin nëpunësi civil me rastin e emërimit si i

funksionar i zgjedhur të ketë qenë rrjedhimisht ka pas të themeluar marrëdhënien e punës në shërbim civil.

Thënë si më sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.02/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit D.J;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Ranillugut; dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.